



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafin 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Re-Publika Marketing & Media Solutions” Sh.P.K të datës 15.03.2023 kundër njoftimit B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar të datës 10.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dizajnimi i identitetit të ri të Kryeqytetit” (faza e parë) me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222, autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Re-Publika Marketing & Media Solutions” Sh.P.K të datës 15.03.2023 kundër njoftimit B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar të datës 10.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dizajnimi i identitetit të ri të Kryeqytetit” (faza e parë) me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222.
- II. **ANULOHE**T njoftimi B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar të datës 10.03.2023.
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të kthej në rivlerësim procedurën lidhur me aktivitetin e prokurimit në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Re-Publika Marketing & Media Solutions” Sh.P.K si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Re-Publika Marketing & Media Solutions" Sh.P.K (tutje "parashtruesi") me datë 15.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar të datës 10.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dizajnimi i identitetit të ri të Kryeqytetit" (faza e parë) me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është si në vijim: *"Me datë 16 janar 2023 janë dërguar me email dokumentet e kërkuara për këtë aplikim të cilat kanë qenë të mbrojtura me fjalëkalim për shkak të konfidencialitetit dhe detyrimeve ndaj palëve të treta. Me datë 17 janar 2023 është dërguar fjalëkalimi për qasje në dokumente"*.

Për shkak të pretendimit si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP") si dhe Rregulloren (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP").

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar si prova raporti i komisionit vlerësues, njoftimi B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar si dhe komunikimet e parashtruesit me autoritetin kontraktues përmes dy (2) emailëve të datës 16 janar 2023 dhe të datës 17 janar 2023.

Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të mjaftueshme dhe të bazuara mirë për të vërtetuar pretendimet e tij. Rrjedhimisht pretendimet e parashtruesit janë të bazuara pasi që nga provat e administruara mund të konfirmohen thëniet në pretendime sipas elaborimeve në vijim.

Përmes dëshmive që ka dorëzuar parashtruesi është gjetur se i njëjti ka dorëzuar brenda afatit dokumentet përkatëse të tenderit. Përmes emailit parashtruesi me datë 16 janar 2023 ka njoftuar autoritetin kontraktues për dorëzimin e dokumenteve në fjalë. Njëkohësisht ka njoftuar se dokumentet janë të kodifikuara (ZIP & ENCRYPTED) për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit dhe detyrimeve ndaj palëve të treta. Sa i përket kodit të hapjes, në të njëjtën email parashtruesi ka lënë edhe një numër të telefonit të personit të autorizuar të operatorit ekonomik.

Tutje me datë 17 janar 2023 parashtruesi ka dërguar edhe një email te autoriteti kontraktues duke dërguar edhe me shkrim kodin për qasje në dokumentet e dorëzuara të tenderit.

Megjithatë komisioni i vlerësimit nuk ka marrë në shqyrtim fare këto komunikime ndërmjet parashtruesit edhe autoritetit kontraktues. Prandaj në mënyrë jo të drejtë është dërguar te parashtruesi edhe njoftimi B58 mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderuesin e eliminuar. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit është pretendim i bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63.1.3. paragrafi b) të RRPP. Për pikën IV dhe pikën V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.03.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit vendimit.